



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 1551 Prot.

Tiranë, më 07.06.2024

VENDIM

Nr. 16, Datë 07.06 2024

**“PËR SHFUQIZIMIN E URDRIT TË NJËSISË KRYESORE TË
FAKULTETIT TË VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT DHE
NJOFTIMIN E DISA MASAVE PËR MBARËVAJTJEN E PROCESIT
ZGJEDHOR NË UST”**

Komisioni Institucional Zgjedhor i UST, në ushtrim të detyrave, funksioneve dhe kompetencave që i përcaktohen në Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UST”, miratuar me vendimin nr. 32, datë 22.04.2024 të Senatit Akademik të UST, mbështetur në nenin 6, pika 2, germa a dhe b; Nenin 38, pika 8, të rregullores së referuar më lart, në vijim të ankesës së dorëzuar nga dy kandidat student për Senat Akademik dhe komunikimit elektronik nga Departamentet për Urdhër të Dekanit pranë FVFR lidhur me fushatën, Komisioni Institucional Zgjedhor:

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë urdhrin e njësisë kryesore, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, drejtuar personelit akademik, subjekteve zgjedhore dhe me objekt aspekte të organizimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në UST.
2. Të rinjoftojë personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, se Komisioni Institucional Zgjedhor, është Institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve dhe Institucioni i vetëm që ushtron kompetencën për: *nxjerrjes së udhëzimeve për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha njësitë e UST-së*”.
3. Personeli akademik që është i angazhuar me mësimdhënien dhe veprimtaritë akademike që përkojnë me oraret dhe afatet e periudhës zgjedhore, duhet të jenë mbështetës dhe bashkëpunës me kandidatët e përfshirë në fushatën elektorale, për krijimin e hapsirës kohore dhe kurdoherë pa cenuar procesin dhe veprimtaritë mësimore.

4. Të rinjoftojë personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, se rregullorja “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UST”; “është e detyrueshme për t`u zbatuar si e tillë nga i gjithë personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ i Universitetit të Sporteve”.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, u njoftohet njësisve kryesore dhe personelit akademik dhe publikohet në faqen zyrtare të UST.
6. Vendimi të publikohet në ambintet e Universitetit të Sporteve të Tiranës.

ERISA ALIAJ

ANËTAR

HOLTJON ORHANI

ANËTAR

OREST SHYTAJ

ANËTAR

ARMANDO CUNGU

ANËTAR

INDRIT REKA

KRYETAR

